

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
UJËSJELLËS KANALIZIMEVE PËR PROJEKTIN**

“Administrimi dhe menaxhimi i tokës komponenti D”

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, Tiranë , për projektin “Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga fillimi i projektit deri 31.08.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 193 datë 31.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 887/7 datë 31.12.2014, dërguar Z. Ardian Alushi, Drejtor i Përgjithshëm , Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. VKM nr. 223, datë 23.03.2011 “Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e Projektit “Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës” dhe VKM nr. 224, datë 23.03.2011 “Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese të financimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e Projektit “Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës” mbi bazën e të cilave është zbatuar Projekti, nuk janë publikuar në Fletoren Zyrtare, për pasojë nuk kanë marrë fuqi juridike, në kundërshtim me nenin 117 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet *“Ligjet, Aktet Normative të Këshillit të Ministrave, të Ministrave, të Institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, të marrë masa për Projektet të cilat do të zbatohen në të ardhmen, të njoftojë Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës që aktet nënligjore në zbatim të projekteve, të marrin fuqi juridike në përputhje me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

Menjëherë

2. Nuk janë plotësuar objektivat e projektit në lidhje me përfundimin e ndërtimit të hidrovorit të Casit (financuar në masën 28 % nga Projekti) dhe rehabilitimi i stacionit të pompave në Trush (financuar në masën 55 % nga Projekti), të cilët janë në proces për t’u realizuar me buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, të marrë masa për realizimin në afat të objektivave të projektit, me qëllim maksimalizimin e përfitimeve dhe uljen e barrës nga buxheti i shtetit.

Menjëherë

3. Projekti është mbyllur më 30 qershor 2014 një vit pas përfundimit të afatit të përcaktuar në marrëveshje më datë 30.06.2013, pa kryer amendimin e Marrëveshjes. Rezulton se ka ndryshim në zbritje të shumës së huasë së alokuar nga 9,187,206 Euro në 7,700,000 Euro dhe ndryshim në rritje të shumës së kredisë së alokuar nga 279,221 SDR në 405,428.91 SDR, pa miratim paraprak, në kundërshtim me VKM nr. 223, datë 23.3.2011 dhe VKM nr. 224 datë 23.3.2011.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa, që për Projektet të cilat do të zbatohen në të ardhmen, për çdo ndryshim të afatit kohor apo planit të financimit të bëhen sipas përcaktimeve të marrëveshjes dhe në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Vazhdimisht

4. Janë paguar si shpenzime operative për anëtarët e NJZP, shpenzimet për telefoninë celulare në vlerën 4,466 USD, shpenzimet e karburantit në vlerën 29,261 USD, një shofer për 31 muaj në vlerën 13,949 USD dhe një punonjëse pastrimi për 32 muaj në vlerën 7,199 USD, të cilët nuk janë parashikuar për të qenë pjesë e stafit në mungesë të miratimit të strukturës së NJZP, pa u autorizuar më parë nga Koordinatori i Projektit (Drejtori i Përgjithshëm i DPUK), në kundërshtim me VKM nr. 224 datë 23.03.2011, pika 3 dhe kontratat individuale Pika 3, gërmat B dhe C, duke **rënduar koston e Projektit në vlerën 54,875 USD**, mungon miratimi i strukturës organike të Njesisë së Zbatimit të Projektit (NJZP), si strukturë përgjegjëse dhe përfaqësuese e DPUK, për menaxhimin dhe zbatimin e Projektit, në kundërshtim me VKM nr. 224 datë 23.03.2011, pika 2/b.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, të marrë masa që për Projektet të cilët do të zbatohen në të ardhmen, të përcaktohet struktura organike e Njesisë së Zbatimit të Projektit, forma e kontraktimit, numri, afatet dhe vlera e kontratave të shërbimit për konsulentët, ku të përfshihen të gjitha shpenzimet për kryerjen e shërbimit dhe të sigurohet monitorimi i realizimit të tyre.

Vazhdimisht

5. Në bazë të kontratës CsFK 1, të lidhur më 05.11.2012, me objekt “Kryerja e studimit hidrogeologjik në zonën e Fushë-Kuqes si pjesë e skemës së sistemit të furnizimit me ujë të rrethit të Durrësit”, është paguar Konsulenti Individual Romeo Eftimiu për vlerën 40,000 USD, kontratë e cila nuk është pjesë e Projektit “Administrimi dhe menaxhimi i tokës, Komponenti D, Ndërhyrja emergjente në zonën Shkodër-Lezhë”, veprim në kundërshtim me VKM nr. 223 datë 23.03.2011 “Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e Projektit “Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës”. Paga e këtyre shpenzimeve për këtë kontratë ka rënduar koston e Projektit **në vlerën 40,000 USD**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, të marrë masa që për Projektet që do të zbatohen në të ardhmen, të kryejë vetëm shpenzime që janë të lidhura me objektin dhe qëllimin e tyre, në përputhje me përcaktimet në marrëveshjet dhe kuadrin ligjor përkatës.

Vazhdimisht

6. Në kundërshtim me Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe kontratat e lidhura me anëtarët e stafit pika 3, nuk janë mbajtur dhe arkëtuar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 4,067,265 lekë, nga anëtarët e stafit të NJZP, përkatësisht: për z. ■■■ në shumën 879,388 lekë, për znj. ■■■ në shumën 879,388 lekë, për znj. ■■■ në shumën 879,388 lekë, për znj. ■■■ në shumën 879,388 lekë dhe për znj. ■■■ në shumën 549,713 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve, të marrë masa për arkëtimin në organet tatimore, të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 4,067,265 lekë, përkatësisht: për z. ■■■ në shumën 879,388 lekë, për znj. ■■■ në shumën 879,388 lekë, për znj. ■■■ në shumën 879,388 lekë, për znj. ■■■ në shumën 879,388 lekë dhe për znj. ■■■ në shumën 549,713 lekë, në zbatim të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

Brenda datës 31.01.2015

7. Dokumentacioni i procedurave prokuruese (prokurimi, zbatimi, kontratat, shtesat, etj.), komunikimi me Bankën Botërore, si dhe një pjesë e dokumentacionit financiar janë kryer në gjuhën angleze dhe jo shqipe, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 14, pika 1 dhe Ligjin nr. 8371, datë 09.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, neni 12. Trajtuar më hollësisht në faqet, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve, të marrë masa që për projektet në vazhdimësi, dokumentacioni themelor i Projektit, në varësi të rëndësisë dhe gjykimit, të jetë dhe në gjuhën shqipe, në zbatim të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 8371, datë 09.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.

Vazhdimisht

8. Nuk vërtetohet zotërimi i gjuhës angleze nga anëtarët e njësive të zbatimit të projektit, titullarëve të autoritetit kontraktor, anëtarëve të komisioneve të vlerësimit të ofertave dhe anëtarëve të njësive të prokurimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve, të marrë masa që për projektet në vazhdimësi, për tenderat që zhvillohen jo në gjuhën shqipe, para lidhjes së kontratave të punësimit, të vërtetohet që titullarët e autoritetit kontraktor, anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave dhe njësive të prokurimit të zotërojnë gjuhën përkatëse.

Vazhdimisht

9. Bazuar në konstatimet e auditimit të Projektit “Administrimi dhe menaxhimi i tokës, Komponenti D, Ndërhyrja emergjente në zonën Shkodër-Lezhë”, i cili është zhvilluar në kushtet e emergjencës dhe në mungesë të politikave afatgjata për investimet e kryera, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit kanë rezultuar mangësi dhe shkelje të shumta gjatë fazës së shpalljes së procedurës, kualifikimit, vlerësimit të operatorëve ekonomikë dhe zbatimit të kontratave të

lidhura, në kundërshtim me Udhëzuesin e Bankës Botërore për Mallra dhe Punime, Maj 2010, si dhe Udhëzuesin Bankës Botërore për Konsulentët Maj 2010.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve, të marrë masa për menaxhimin me efektivitetet të investimeve të kryera nga Projekti, si ato të konsulentëve, teknologjisë dhe të ndërtimit, si dhe të ndërtohen politika afatgjatë në fushën e Projekteve, duke njohur dhe zbatuar udhëzuesit e financuesit dhe sipas rastit legjislacionin shqiptar.

Vazhdimisht

10. Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla ka rezultuar se: -në 7 raste janë kryer pagesa të blerjeve të vogla pa procedurë prokurimi, konkretisht në vitin 2011 për 1 rast në vlerën 207,000 lekë, për vitin 2012 për 5 raste në vlerën 267,389 lekë, në vitin 2013 për 1 rast në vlerën 98,000 lekë,

-në 30 raste në procedurën e prokurimit mungonin ofertat, konkretisht në vitin 2011 është 1 rast në vlerën 14,000 lekë, në vitin 2012 janë 17 raste në vlerën 287,907 lekë, në vitin 2013 janë 10 raste në vlerën 414,031 lekë, dhe në vitin 2014 janë 2 raste në vlerë 68,729 lekë,

-për procedurat e prokurimit të karburantit, mungon miratimi i Bankës Botërore për këto procedura, urdhri i prokurimi është lëshuar nga Drejtori i NJZP dhe jo nga Drejtori i DPUK-së (koordinatori i Projektit), formulari i njoftimit të fituesit nuk është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe në dosjen e Tenderit nuk u gjet dokumentacioni i operatorëve të tjerë pjesëmarrës, veprime në kundërshtim me Udhëzuesin e prokurimeve të Bankës Botërore Maj 2010, pika 3.5 “Blerjet”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve, të marrë masa për të unifikuar procedurat për blerje me vlera të vogla, si masa të nevojshme dhe si një mjet i domosdoshëm që përmirëson menaxhimin dhe administrimin e projekteve me financime të huaja, me synim rritjen e efektivitetit dhe arritjen e objektivave të tyre, duke zbatuar udhëzuesit e financuesit dhe sipas rastit legjislacionin shqiptar.

Vazhdimisht

11. Dokumentacioni i Projektit në tërësi nuk është i protokolluar dhe i inventarizuar, në korrespondencat e protokollit nuk janë regjistruar dokumentet financiare, të prokurimit etj., veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve, të marrë masa për të arkivuar dhe inventarizuar të gjithë dokumentacionin e Projektit, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003: “Për arkivat”, i ndryshuar.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Në zbatimin e punimeve të kontratës “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujrave të shiut në qytetin e Shkodrës Pallati me Urë-Parrucë”, rezultuan diferenca në zëra dhe volume të përfituara padrejtësisht nga shoqëria ”[REDAKTUAR]”, me dëm ekonomik në **vlerën 920,604 lekë**, mungon Leja Mjedisore për kryerjen e punimeve, në dosjen teknike nuk disponohet dokumentacioni për masat

e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse, nuk është bërë njoftim me shkrim në seksionin e urbanistikës pranë organeve të qeverisjes vendore, Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik në nivel komune/bashkie/qarku, drejtoritë rajonale tatimore dhe INUK-ut, mungon Plan-organizimi i punimeve të ndërtimit, mungon raporti përfundimtar i realizimit të punimeve nga mbikëqyrësi i punimeve, mungojnë çertifikatat profesionale (licencat), të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit (shoqërisë sipërmarrëse dhe mbikëqyrësit), si dhe mungon pasqyra e realizimit të punimeve (regjistri i kontabilitetit), në kundërshtim me VKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me VKM nr. 1, datë 16.06.2011.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **920,604 lekë** si përfitim i padrejtë nga Shoqëria “**██████**”, për diferencat e konstatuara në punimet e kryera me objekt “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të shiut në qytetin e Shkodrës Pallati me Urë-Parrucë”, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizimeve.

Menjëherë

2. Në zbatimin e punimeve të kontratës “Furnizimi dhe instalimi i pompave të drenazhimit, panele elektrik, dhe punime civile për stacionin e pompave të drenazhit Velipojë”, rezultuan diferenca në zëra dhe volume të përfituara padrejtësisht nga shoqëria “**██████**”, me **dëm ekonomik në vlerën 27,008.57 USD**, mungon Leja Mjedisore për kryerjen e punimeve, në dosjen teknike nuk disponohet dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse, nuk është bërë njoftim me shkrim në seksionin e urbanistikës pranë organeve të qeverisjes vendore, Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik në nivel komune/bashkie/qarku, drejtoritë rajonale tatimore dhe INUK-ut, mungon Plan-organizimi i punimeve të ndërtimit, mungon raporti përfundimtar i realizimit të punimeve nga mbikëqyrësi i punimeve, mungojnë çertifikatat profesionale (licencat), të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit (shoqërisë sipërmarrëse dhe mbikëqyrësit), si dhe mungon pasqyra e realizimit të punimeve (regjistri i kontabilitetit), në kundërshtim me VKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me VKM nr. 1, datë 16.06.2011.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **27,008.57 USD** si përfitim i padrejtë nga Shoqëria “**██████**”, për diferencat e konstatuara në punimet e kryera me objekt “Furnizimi dhe instalimi i pompave të drenazhimit, panele elektrik, dhe punime civile për stacionin e pompave të drenazhit Velipojë”, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizimeve.

Menjëherë

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Alfonc Gabili, Irma Shkupi, Besim Sinani, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Sekretari i Përgjithshëm Luljeta Nano.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT